



Republika e Kosovës
Republika Kosova/Republic of Kosovo
Akademia e Drejtësisë/Akademija Pravde/Academy of Justice

Përditësimi i Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë për vitin 2024-2026

Janar 2026

Më 19.01.2026 është bërë përditësimi i Planit të Integritetit, në përputhje me nevojat dhe zhvillimet institucionale, me miratimin e Këshillit Drejtues të Akademisë së Drejtësisë përmes Drejtorit Ekzekutiv.

©**Akademia e Drejtësisë 2026**, Të gjitha të drejtat e rezervuara. Përmbajtja e këtij materiali nuk mund të rishtypet, shumëzohet ose përcjellët në çfarëdo forme tjetër elektronike, mekanike, të fotokopjohet ose regjistrohet pa miratimin me shkrim të Akademisë së Drejtësisë.



Tabela e përmbajtjes

1. Hyrje	4
2. Përditësimi i Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë (AD)	4
2.1 Qëllimi i përditësimit të Planit të Integritetit të AD-së.....	5
3. Veprimtaria e Akademisë së Drejtësisë dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion.....	6
4. Vetëvlerësimi i ekspozimit të Akademisë së Drejtësisë ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit	7
5. Llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe masat ekzistuese të kontrollit	8
6. Masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit për periudhën 2024-2026	10
7. Informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e procesit të përditësimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit të Integritetit	13
8. Të dhëna të tjera në përputhje me Metodologjinë për rishikimin e Planit të Integritetit.....	13
9. Matrica e përditësuar e vlerësimit të rrezikut	14

1. Hyrje

Në përputhje me nenin 25 të Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe në bazë të Metodologjisë dhe udhëzimeve në fuqi të miratuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Akademia e Drejtësisë ka miratuar Planin e Integritetit për periudhën 2024–2026.

Në kuadër të zbatimit të këtij Plani dhe në përputhje me kërkesat për rishikim periodik, Akademia e Drejtësisë ka realizuar përditësimin e Planit të Integritetit, i cili përfshin masat dhe veprimet për vitin 2026, duke reflektuar zhvillimet institucionale dhe ligjore të ndodhura gjatë periudhës së zbatimit.

Plani i Integritetit është dokument strategjik dhe operativ që synon identifikimin, vlerësimin dhe trajtimin e rreziqeve që mund të cenojnë integritetin institucional, transparencën dhe funksionimin e rregullt të Akademisë së Drejtësisë. Ai shërben si instrument për parandalimin e korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit, përmes përcaktimit të masave parandaluese dhe forcimit të mekanizmave të kontrollit të brendshëm.

Në kuadër të këtij përditësimi, Akademia e Drejtësisë ka realizuar vetëvlerësimin e ekspozimit ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe rreziqeve të tjera që cenojnë integritetin institucional, me fokus të veçantë në vitin 2026.

Përditësimi i Planit të Integritetit dorëzohet në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, ndërsa zbatimi i tij monitorohet në mënyrë të vazhdueshme nga zyrtari përgjegjës për integritet në Akademinë e Drejtësisë. Raportimi për nivelin e zbatimit të masave të parapara bëhet në baza periodike, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e përcaktuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

Në vijim të këtij dokumenti, përmes matricës së rrezikut, paraqiten në mënyrë të strukturuar rreziqet e identifikuara, masat e kontrollit dhe parandaluese të përditësuara për vitin 2026, si dhe veprimet e planifikuara dhe të ndërmarra nga njësitë përgjegjëse të Akademisë së Drejtësisë.

2. Përditësimi i Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë (AD)

Përditësimi i Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë për periudhën 2024–2026 realizohet në kuadër të zbatimit të Planit të miratuar dhe përfshin rishikimin dhe përditësimin e masave dhe veprimeve të planifikuara për vitin 2026. Ky përditësim synon forcimin e mekanizmave të integritetit, rritjen e transparencës dhe llogaridhënies institucionale, si dhe sigurimin e funksionimit të ligjshëm, profesional dhe të paanshëm të Akademisë së Drejtësisë dhe mbetet i vlefshëm deri në fund të vitit 2026 duke mos cenuar strukturën bazë të Planit të Integritetit të miratuar 2024-2026.

Procesi i përditësimit ka për qëllim rishikimin e vlerësimit të rrezikut të korrupsionit dhe formave të tjera që cenojnë integritetin institucional, në funksion të zhvillimeve institucionale, ligjore dhe organizative të ndodhura gjatë zbatimit të Planit. Në këtë kuadër janë rishikuar rreziqet e identifikuar më herët, janë vlerësuar masat ekzistuese të kontrollit dhe sipas nevojës janë përditësuar ose përcaktuar masa shtesë parandaluese.

Përditësimi i Planit të Integritetit pasqyron përkushtimin e vazhdueshëm të Akademisë së Drejtësisë ndaj forcimit të integritetit institucional, transparencës dhe llogaridhënies, përmes identifikimit sistematik të rreziqeve potenciale dhe zbatimit të masave të përshtatshme për parandalimin e korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit.

Objektivat e përditësimit të Planit të Integritetit të AD-së janë:

- Rritja e transparencës institucionale përmes publikimit të rregullt të informacioneve dhe raporteve zyrtare;
- Sigurimi i zbatimit të programeve të trajnimit në përputhje me standardet profesionale, përmes angazhimit të trajnerëve me përgatitje adekuate;
- Zhvillimi i programeve të trajnimit të bazuara në nevojat reale dhe të dokumentuara të përfituesve;
- Forcimi dhe standardizimi i procedurave të rekrutimit për pozitat e lira, në përputhje me parimet e transparencës, barazisë dhe meritokracisë;
- Harmonizimi i legjislacionit dhe akteve të brendshme të Akademisë së Drejtësisë me standardet dhe praktikat më të mira të Bashkimit Evropian.

2.1 Qëllimi i përditësimit të Planit të Integritetit të AD-së

Qëllimi i përditësimit të Planit të Integritetit të Akademisë së Drejtësisë është forcimi i integritetit institucional përmes rritjes së transparencës dhe llogaridhënies, si dhe parandalimit dhe menaxhimit efektiv të rreziqeve të korrupsionit dhe shkeljeve të tjera të integritetit në veprimtarinë e institucionit.

Përditësimi i Planit synon avancimin e mekanizmave ekzistues të kontrollit të brendshëm dhe përcaktimin e masave parandaluese për vitin 2026, me qëllim sigurimin e funksionimit të ligjshëm, profesional dhe të paanshëm të Akademisë së Drejtësisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe standardet e Bashkimit Evropian.

Në vijim të këtij kapitulli, përmes matricës së rrezikut, paraqiten rreziqet e identifikuar, vlerësimi i tyre, masat ekzistuese dhe të përditësuara të kontrollit, njësitë përgjegjëse për zbatim, afatet dhe statusi i realizimit për vitin 2026.

3. Veprimtaria e Akademisë së Drejtësisë dhe burimet njerëzore të angazhuara në institucion

Bazuar në Ligjin Nr. 05/L -095 për AD-në, si dhe të Ligjit nr. 08/L-063, kapitulli IV për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 05/L-095 për Akademinë e Drejtësisë, Akademia është institucion publik i pavarur e cila si funksion kryesor ka ngritjen e kapaciteteve profesionale të gjyqtarëve, prokurorëve, stafit administrativ gjyqësor dhe prokurorial si dhe sipas kërkesave dhe mundësive edhe për profesionet e lira. Këtë funksion e realizon përmes zhvillimit dhe zbatimit të programeve trajnuese në përputhje me nevojat adekuate që rrjedhin si rezultat i zbatimit të mekanizmave vlerësues. Përveç kësaj kryen edhe analiza, hulumtime si dhe veprimtari botuese për nevojat e sistemit gjyqësor dhe prokurorial si dhe profesioneve tjera të lira.

Vija llogaridhënëse sipas *Ligjit nr. 08/L-063 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që kanë të bëjnë me racionalizimin dhe vendosjen e vijave llogaridhënëse të agjencive të pavarura* është te Këshilli Drejtues i saj si organ më i lartë me kompetenca vendimmarrëse. Ky organ ka në përbërje nëntë (9) anëtarë, nga të cilët dy (2) janë anëtarë ex officio, ndërsa shtatë (7) anëtarë nga institucionet e mëposhtme:

Anëtarë ex officio janë Kryetari i Gjykatës Supreme dhe Kryeprokurori i Shtetit. Anëtarët tjerë janë:

- a. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KGJK dhe atë, një (1) gjyqtar nga Gjykata Themelore, një (1) nga Gjykata e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KGJK-së;
- b. 3 (tre) anëtar të emëruar nga KPK dhe atë, një (1) prokuror nga Prokuroria Themelore, një (1) nga Prokuroria e Apelit dhe një (1) nga Sekretariati i KPK-së;
- c. 1 (një) anëtar i emëruar nga Ministria e Drejtësisë;

Anëtarët e Këshillit Drejtues emërohen në kohëzgjatje prej katër (4) vite, pa mundësi rizgjedhje edhe për një mandat.

Sipas ligjit, Këshilli Drejtues i Akademisë ka kompetencë për:

- a. Miratimin e akteve nënligjore të përcaktuara me këtë ligj;
- b. Miratimin e projektbuxhetit të Akademisë;
- c. Miratimin e strategjisë zhvillimore, planit të punës së Akademisë dhe programit të trajnimeve;
- d. Miratimin e listës së trajnerëve dhe mentorëve;
- e. Mbikëqyrjen e punës së Akademisë;
- f. Përcaktimin e prioritetëve në ofrimin e trajnimeve në bashkëpunim me KGJK-në dhe KPK-në;
- g. Zgjedhjen dhe shkarkimin e Drejtorit Ekzekutiv;
- h. Emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të Këshillit Programor;
- i. Kryerjen e punëve tjera të përcaktuara me ligj dhe akte nënligjore;

Pas Këshillit Drejtues është Këshilli Programor i cili përbëhet prej shtatë (7) anëtarëve, të cilët i emëron Këshilli Drejtues, nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve të shtetit dhe ekspertëve tjerë. Mandati i anëtarëve të Këshillit Programor është katër (4) vite me të drejtë rizgjedhjeje edhe për një mandat. Kryesuesi i Këshillit Programor është ex officio Drejtori Ekzekutiv i Akademisë.

Këshilli Programor është organ ndihmës profesional i cili angazhohet për hartimin e Programit të Trajnimeve dhe për të siguruar cilësi për trajnimet e ofruara nga AD. Përveç kësaj ka në mandat edhe funksionet tjera si në vijim:

- Përcjellja e realizimit të programeve dhe sukseseve të tyre;
- Të jap orientime për avancimin e metodave dhe teknikave trajnuese, pavarësisht dhe në bashkëpunim me trajnuesit dhe mentorët;
- Të jap mendim për listën e trajnuesve dhe mentorëve;
- Të jap këshilla propozime dhe sugjerime, organeve të Akademisë për përmirësimin e kualitetit të trajnimeve;
- Kryejnë edhe punë tjera të përcaktuara me këtë ligj dhe akte nënligjore të Akademisë.

Organet e lartpërmendura, anëtarët e të cilëve kanë mandatet e tyre siç është potencuar nuk janë rezident në Akademi meqë kanë edhe funksionet e tyre primare në institucionet të cilat i përfaqësojnë. Këto organe mbliidhen sipas nevojave dhe shqyrtojnë si dhe vendosin për proceset e punës, programet dhe çështjet tjera për funksionimin më të mirë të AD-së. Ngjashëm me këto organe janë edhe trajnuesit e jashtëm të cilët vijnë nga radhët e gjyqtarëve, prokurorëve dhe profesionistëve tjerë ligjor dhe të njëjtit edhe pse nga jashtë, janë faktorë kyç në zbatimin e programeve trajnuese.

Në Akademinë e Drejtësisë janë të punësuar 29 zyrtarë duke përfshirë edhe Drejtorin Ekzekutiv, ndërkaq janë të lejuara gjithsej 32 pozita.

Një pjesë e konsiderueshme e stafit është i angazhuar në procesin e vlerësimit të nevojave trajnuese, në zhvillimin e programeve dhe në zbatimin e trajnimeve, ndërkaq pjesa tjetër e stafit në fushën e administratës, financave, prokurimit dhe shërbimeve tjera në zbatim të funksioneve të përcaktuara me Ligjin për Akademinë e Drejtësisë.

4. Vetëvlerësimi i ekspozimit të Akademisë së Drejtësisë ndaj korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit

Mashtrimi dhe korrupsioni cenojnë rëndë vlerat e shoqërisë, institucionet dhe rendin juridik të shtetit. Në funksion të parandalimit të këtyre dukurive dhe në përputhje me Ligjin për parandalimin e korrupsionit, institucionet publike, përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë, janë të obliguara të shqyrtojnë në mënyrë të vazhdueshme potencialet brenda institucionit, procedurat dhe proceset e punës

që mund të krijojnë hapësirë për sjellje që cenojnë parimet etike, vlerat morale dhe integritetin institucional.

Mashtrimi dhe korrupsioni përbëjnë rreziqe serioze për funksionimin e institucioneve publike, cenojnë besimin e publikut dhe dëmtojnë sundimin e ligjit. Në këtë kontekst, parandalimi i këtyre dukurive kërkon qasje të vazhdueshme, sistematike dhe proaktive nga institucionet publike, përfshirë edhe Akademinë e Drejtësisë.

Në përputhje me Ligjin nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Metodologjinë për hartimin dhe përditësimin e Planeve të Integritetit, Akademia e Drejtësisë ka realizuar procesin e vetëvlerësimit të ekspozimit ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe formave të tjera të shkeljes së integritetit institucional. Ky proces është zhvilluar në kuadër të përditësimit të Planit të Integritetit për vitin 2026 dhe është bazuar në analizën e përvojës së zbatimit të Planit paraprak, vlerësimin e masave ekzistuese të kontrollit dhe shqyrtimin e zhvillimeve institucionale dhe ligjore.

Vetëvlerësimi është fokusuar në identifikimin e proceseve të punës, procedurave administrative dhe vendimmarrëse që, për shkak të natyrës së tyre, mund të jenë të ekspozuara ndaj rreziqeve të korrupsionit, konfliktit të interesit, mungesës së transparencës ose cenimit të parimeve etike. Përmes këtij procesi janë analizuar shkaqet potenciale të rreziqeve, ndikimi i tyre në funksionimin institucional dhe efektiviteti i masave ekzistuese të kontrollit.

Në kuadër të këtij procesi, Grupi punues për përditësimin e Planit të Integritetit ka zhvilluar takime gjatë fazës përgatitore, me qëllim rishikimin e gjetjeve ekzistuese, sqarimin e kërkesave ligjore dhe harmonizimin e masave parandaluese me gjendjen reale institucionale. Si rezultat i këtij procesi, janë identifikuar fushat kryesore të rrezikut, llojet e rreziqeve dhe format potenciale të shkeljes së integritetit, si dhe janë përcaktuar masat përkatëse për parandalimin dhe trajtimin e tyre.

Në vijim të këtij plani janë përcaktuar llojet e rreziqeve dhe formave tjera potenciale të shkeljes së integritetit.

5. Llojet e rreziqeve të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit dhe masat ekzistuese të kontrollit

Në vijim të procesit të vetëvlerësimit, Akademia e Drejtësisë ka identifikuar rreziqet kryesore që lidhen me funksionet dhe proceset e saj themelore. Këto rreziqe janë vlerësuar në raport me ndikimin e tyre të mundshëm në integritetin institucional dhe janë shoqëruar me masa ekzistuese dhe të përditësuara të kontrollit, me qëllim minimizimin dhe menaxhimin e tyre efektiv.

5.1 Publikimi i raporteve dhe njoftimeve institucionale

Rreziku i cenimit të integritetit mund të shfaqet në rastet kur raportet, njoftimet, informacionet dhe dokumentet institucionale nuk publikohen në mënyrë të rregullt, të plotë dhe në kohë. Mungesa e transparencës në publikimin e këtyre informacioneve mund të krijojë perceptim për shmangie të llogaridhënies institucionale dhe të ndikojë negativisht në besimin e publikut ndaj veprimtarisë së Akademisë së Drejtësisë.

Ky rrezik lidhet kryesisht me procedurat e brendshme të publikimit, koordinimin ndërmjet njësive përgjegjëse dhe respektimin e afateve të përcaktuara. Masat ekzistuese të kontrollit synojnë sigurimin e publikimit të rregullt dhe të standardizuar të raporteve dhe njoftimeve zyrtare, si dhe garantimin e qasjes së barabartë të publikut në informacionet institucionale.

5.2 Angazhimi i trajnerëve me përgatitje të avancuar profesionale në zbatim të programit të trajnimit

Rreziku i cenimit të integritetit në këtë fushë mund të paraqitet në rastet kur përzgjedhja dhe angazhimi i trajnerëve nuk bazohet në kritere të qarta profesionale dhe meritore, kur ekziston konflikt interesi, mungesë transparence dhe llogaridhënie ose ndikim subjektiv në vendimmarrje.

Masat ekzistuese të kontrollit janë të orientuara drejt standardizimit të procedurave të angazhimit, bazuar në përvojë dhe sjelljes profesionale, parandalimit të konfliktit të interesit, me qëllim sigurimin e cilësisë dhe besueshmërisë së programeve të trajnimit.

5.3 Programet e trajnimit sipas nevojave reale të përfituesve

Rreziku shfaqet në rastet kur programet e trajnimit nuk bazohen në analiza të dokumentuara të nevojave reale të përfituesve, kur përmbajtja e tyre nuk është e përshtatur me zhvillimet ligjore dhe praktike ose kur ndikime të jashtme ndikojnë në përcaktimin e prioritetëve trajnuesë. Kjo situatë mund të çojë në përdorim joefikas të burimeve dhe ulje të efektivitetit të programeve të trajnimit.

Masat e kontrollit synojnë sigurimin e një procesi të strukturuar të vlerësimit të nevojave trajnuese dhe harmonizimin e programeve të trajnimit me kërkesat reale të sistemit të drejtësisë.

5.4 Procesi i rekrutimit të pozitave të lira

Rreziku i korrupsionit dhe cenimit të integritetit mund të ndodhë gjatë procesit të rekrutimit në rastet e mungesës së transparencës, favorizimit, konfliktit të interesit ose mosrespektimit të procedurave dhe kritereve të përcaktuara. Po ashtu, rrezik paraqitet edhe kur dokumentacioni i kandidatëve nuk vlerësohet në mënyrë objektive dhe të barabartë.

Masat ekzistuese të kontrollit fokusohen në respektimin rigoroz të procedurave të

rekrutimit, dokumentimin e procesit vendimmarrës dhe sigurimin e trajtimit të barabartë të kandidatëve, në përputhje me parimet e transparencës dhe meritokracisë.

5.5 Avancimi dhe fuqizimi i legjislacionit të AD-së në përputhje me standardet e BE-së

Rreziku në këtë fushë lidhet me mundësinë e mos përditësimit në kohë të akteve normative të brendshme, mungesën e harmonizimit me standardet evropiane ose zbatimin jo të njëtrajshëm të tyre. Mangësitë në këto akte dhe në mekanizmat e monitorimit mund të krijojnë hapësirë për interpretime subjektive dhe zbatim jo të barabartë të rregullave.

Masat e kontrollit synojnë rishikimin dhe përditësimin e vazhdueshëm të legjislacionit dhe akteve të brendshme të Akademisë së Drejtësisë, si dhe sigurimin e zbatimit të tyre të njëtrajshëm dhe në përputhje me standardet e Bashkimit Evropian.

6. Masat parandaluese për zvogëlimin e rrezikut të korrupsionit dhe format e tjera të shkeljes së integritetit për periudhën 2024-2026

Plani i përditësuar i Integritetit për periudhën 2024–2026 përfshin masa ekzistuese që vazhdojnë të zbatohen, si dhe masa të përditësuara dhe shtesë parandaluese, të përcaktuara në bazë të rishikimit të fushave të rrezikut dhe nevojës për forcimin e mekanizmave të integritetit institucional në Akademinë e Drejtësisë.

Masat parandaluese janë të orientuara drejt adresimit të rreziqeve të identifikuara gjatë procesit të vetëvlerësimit dhe synojnë parandalimin, minimizimin dhe menaxhimin efektiv të situatave që mund të cenojnë transparencën, paanshmërinë, llogaridhënien dhe besimin publik në veprimtarinë e Akademisë së Drejtësisë.

6.1 Masa parandaluese lidhur me publikimin e raporteve dhe njoftimeve institucionale (pika 5.1)

Rreziku i cenimit të integritetit institucional mund të shfaqet në rastet kur raportet, njoftimet dhe dokumentet zyrtare nuk publikohen në mënyrë të rregullt, të plotë dhe në kohë. Situata të tilla mund të ndikojnë negativisht në transparencën institucionale dhe të krijojnë perceptim për mungesë llogaridhënie.

Me qëllim të parandalimit të këtij rreziku, Akademia e Drejtësisë do të zbatojë publikimin sistematik dhe të standardizuar të dokumenteve kryesore institucionale, përfshirë Planin e Punës dhe Performancës, raportet tremujore dhe vjetore, raportet e monitorimit, si dhe vendimet e Këshillit Drejtues si organi më i lartë vendimmarrës i institucionit.

Publikimi i këtyre dokumenteve do të realizohet përmes web-faqes zyrtare të Akademisë së Drejtësisë, duke siguruar që informacionet të jenë të qarta dhe të përditësuara. Këto masa kanë për qëllim forcimin e transparencës, rritjen e llogaridhënies institucionale dhe parandalimin e çdo forme të perceptimit të mungesës së integritetit në punën e Akademisë.

6.2 Masa parandaluese lidhur me angazhimin e trajnerëve me përgatitje të avancuar profesionale (pika 5.2)

Rreziku i cenimit të integritetit në procesin e angazhimit të trajnerëve vlerësohet si i ulët, për shkak të masave ekzistuese të kontrollit që zbatohen nga Akademia e Drejtësisë. Megjithatë, për të parandaluar çdo rrezik potencial që mund të ndikojë në cilësinë, paanshmërinë dhe besueshmërinë e programeve të trajnimit, parashihen masa shtesë parandaluese.

Akademia e Drejtësisë do të vazhdojë zbatimin e kriterëve të qarta, të shkruara dhe transparente për përzgjedhjen dhe angazhimin e trajnerëve dhe mentorëve, në përputhje me rregulloren përkatëse. Angazhimi i trajnerëve do të realizohet përmes konkursit publik dhe konkurrues, duke respektuar parimet e meritokracisë dhe paanshmërisë.

Si masa shtesë parandaluese parashihet:

- Rishikimi i vazhdueshëm i kriterëve për vlerësimin e performancës së trajnerëve, bazuar në vlerësimet e pjesëmarrësve dhe monitorimin e cilësisë së trajnimeve;
- Shmangia e konfliktit të interesit, duke mos angazhuar si trajnerë individë që janë njëkohësisht anëtarë të Këshillit Drejtues ose Këshillit Programor;
- Publikimi i listës së trajnerëve të miratuar;
- Miratimi paraprak i angazhimit të trajnerëve nga Këshilli Drejtues.

Këto masa synojnë rritjen e transparencës, forcimin e integritetit dhe garantimin e cilësisë së programeve trajnuese.

6.3 Masa parandaluese lidhur me programet e trajnimit sipas nevojave reale të përfituesve (pika 5.3)

Rreziku i cenimit të integritetit mund të shfaqet në rastet kur programet e trajnimit nuk bazohen në analiza të plota dhe të dokumentuara të nevojave reale të përfituesve, duke ndikuar në efektivitetin e trajnimeve dhe përdorimin efikas të burimeve.

Për parandalimin e këtij rreziku, Akademia e Drejtësisë do të forcojë mekanizmat për identifikimin dhe vlerësimin e nevojave trajnuese përmes bashkëpunimit dhe koordinimit të vazhdueshëm me institucionet e sistemit të drejtësisë, përfshirë Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës, Gjykatat, Prokuroritë, praktikantët e mira ndërkombëtare dhe institucionet e tjera relevante.

Masat parandaluese përfshijnë analizimin sistematik të raporteve të monitorimit të trajnimeve, vlerësimet e pjesëmarrësve, si dhe përfshirjen aktive të gjyqtarëve dhe prokurorëve në procesin e identifikimit të nevojave trajnuese. Këto masa synojnë sigurimin që programet e trajnimit të jenë të orientuara drejt nevojave konkrete, prioritetëve institucionale dhe zhvillimeve ligjore.

6.4 Masa parandaluese lidhur me procesin e rekrutimit të pozitave të lira (pika 5.4)

Procesi i rekrutimit konsiderohet si një fushë me ndjeshmëri të lartë ndaj rreziqeve të korrupsionit dhe shkeljes së integritetit, për shkak të mundësisë së ndikimeve të jashtme, favorizimit ose mungesës së transparencës.

Me qëllim të parandalimit të këtyre rreziqeve, Akademia e Drejtësisë do të sigurojë zbatimin e kriterëve të qarta, objektive dhe transparente për të gjitha procedurat e rekrutimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil dhe aktet nënligjore përkatëse. Procesi do të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me institucionet kompetente të shërbimit civil.

Si masa shtesë parandaluese parashihen:

- Themelimi i komisioneve të paanshme pa konflikt interesi;
- Monitorimi i vazhdueshëm i procesit të rekrutimit;
- Dokumentimi dhe raportimi i rregullt institucional për statusin e çdo procedure rekrutimi.

Këto masa synojnë eliminimin e çdo forme të favorizimit dhe forcimin e besimit në proceset rekrutuese.

6.5 Masa parandaluese lidhur me avancimin dhe fuqizimin e legjislacionit të Akademisë së Drejtësisë në përputhje me standardet e BE-së (pika 5.5)

Rreziku i cenimit të integritetit mund të shfaqet në rastet kur kuadri ligjor dhe nënligjor nuk përditësohet në mënyrë të vazhdueshme ose nuk harmonizohet me zhvillimet ligjore dhe standardet evropiane.

Për parandalimin e këtij rreziku, Akademia e Drejtësisë do të angazhohet në rishikimin dhe avancimin e vazhdueshëm të legjislacionit dhe akteve të brendshme normative, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, Këshillin Gjyqësor të Kosovës, Këshillin Prokurorial të Kosovës dhe akterë të tjerë relevantë.

Masat parandaluese përfshijnë harmonizimin e kuadrit normativ me standardet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet relevante, përfshirë ato të Komisionit të Venecias, me qëllim qartësimin e kompetencave institucionale, unifikimin e praktikës dhe forcimin e integritetit në proceset vendimmarrëse të Akademisë së Drejtësisë.

7. Informacion për personin përgjegjës për menaxhimin e procesit të përditësimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit të Integritetit

Në përputhje me kërkesat e Ligjit nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit dhe Metodologjinë për hartimin dhe përditësimin e Planeve të Integritetit, Akademia e Drejtësisë ka caktuar zyrtaren përgjegjëse për menaxhimin e procesit të përditësimit, zbatimit dhe monitorimit të Planit të Integritetit.

Zyrtarja përgjegjëse për integritet në Akademinë e Drejtësisë është znj. Shehrie Leci – Rudari, e cila ushtron funksionin e Drejtoreshës së Departamentit për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme.

Në këtë cilësi, zyrtarja përgjegjëse koordinon procesin e zbatimit të masave të parapara në Planin e Integritetit, monitoron realizimin e tyre nga njësitë përgjegjëse dhe siguron raportimin periodik mbi nivelin e zbatimit të Planit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe procedurat e përcaktuara nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

8. Të dhëna të tjera në përputhje me Metodologjinë për rishikimin e Planit të Integritetit

Procesi i përditësimit të Planit të Integritetit është realizuar nga Grupi punues i themeluar për këtë qëllim, i cili ka qenë i angazhuar në rishikimin e fushave ekzistuese të rrezikut, vlerësimin e masave të kontrollit dhe identifikimin e nevojës për masa shtesë parandaluese, duke u bazuar në rezultatet e procesit të vetëvlerësimit, përvojën e fituar gjatë zbatimit të Planit paraparak dhe zhvillimet institucionale dhe funksionale të Akademisë së Drejtësisë.

Përditësimi i Planit është realizuar në përputhje me kërkesat e Metodologjisë për hartimin dhe rishikimin e Planit të Integritetit dhe synon forcimin e masave parandaluese, qartësimin e përgjegjësisë institucionale dhe rritjen e efektivitetit në menaxhimin e rreziqeve që cenojnë integritetin institucional.

Për masat ekzistuese që vazhdojnë të zbatohen, si dhe për masat e përditësuara dhe të reja parandaluese, do të realizohet monitorim i vazhdueshëm me qëllim vlerësimin e efektivitetit të tyre dhe sigurimin e zbatimit të plotë, në përputhje me afatet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në Plan.

Raportimi mbi zbatimin e Planit të përditësuar të Integritetit do të bëhet në baza periodike në Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe procedurat e raportimit të përcaktuara nga ky institucion.

9. Matrica e përditësuar e vlerësimit të rrezikut

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
1.	Publikimi i raporteve dhe njoftimeve institucionale	Rreziku i cenimit të integritetit institucional mund të shfaqet në rastet kur raportet, njoftimet dhe dokumentet zyrtare të Akademisë së Drejtësisë nuk publikohen në mënyrë të rregullt, të plotë dhe në kohë, ose	Publikimi i pjesshëm i raporteve dhe njoftimeve përmes web-faqes zyrtare të Akademisë së Drejtësisë.	3	3	5	Vendosja e një sistemi të standardizuar për publikimin e rregullt dhe në kohë të dokumenteve kryesore institucionale, përfshirë planin e punës dhe performancës, raportet tremujore dhe vjetore, raportet e monitorimit, informacionet mbi aktivitetet trajnuese dhe vendimet e Këshillit Drejtues, me	Departamenti i Programeve Trajnuese	Janar - Dhjetor 2026

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
		kur qasja e publikut në informacion është e kufizuar. Kjo situatë mund të krijojë perceptim për mungesë transparence dhe llogaridhënie institucionale.					qëllim forcimin e transparencës dhe rritjen e llogaridhënies institucionale të AD-së.		
2.	Angazhimi i trajnerëve me përgatitje të avancuar profesionale në zbatim të programit të trajnimit	Rreziku i shkeljes së integritetit mund të paraqitet në rastet kur angazhimi i trajnerëve nuk bazohet në kritere të qarta profesionale dhe	Zbatimi i kriterëve të përcaktuara në rregulloren për trajnerë dhe mentorë, konkursi publik dhe miratimi i listës së trajnerëve nga Këshilli Drejtues si dhe angazhimi.	3	3	8	Rishikimi i vazhdueshëm i kriterëve për vlerësimin e performancës së trajnerëve, bazuar në vlerësimet e pjesëmarrësve dhe monitorimin e cilësisë së trajnimeve;	Departamenti i Programeve Trajnuese	Janar-Dhjetor 2026

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
		meritore, kur ekziston konflikt interesi ose mungesë transparence në procesin e përzgjedhjes, angazhimit, duke ndikuar në cilësinë dhe efektivitetin e trajnimeve.					publikimi i listës së trajnerëve të miratuar; si dhe parandalimi i konfliktit të interesit përmes mos angazhimit të anëtarëve të Këshillit Drejtues dhe Këshillit Programor si trajnerë.		
3.	Programet e trajnimit sipas nevojave reale të përfituesve	Rreziku i cenimit të integritetit mund të shfaqet në rastet kur programet e trajnimit bazohen në vlerësim të pjesshëm ose jo	Identifikimi i nevojave trajnuese përmes mekanizmave të vlerësimit dhe koordinimit me institucionet e sistemit të drejtësisë.	3	3	8	Forcimi i bashkëpunimit ndërinstitucional për identifikimin e nevojave trajnuese; analizimi sistematik i raporteve të monitorimit dhe vlerësimeve të	Departamenti i Programeve Trajnuese	Janar-Dhjetor 2026

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
		të sistematizuar të nevojave reale të përfituesve, duke ndikuar në efektivitetin e trajnimeve dhe përdorimin racional të burimeve.					pjesëmarrësve; si dhe përfshirja aktive e gjyqtarëve dhe prokurorëve në procesin e hartimit dhe përditësimit të programeve trajnuese.		
4.	Procesi i rekrutimit të pozitave të lira	Për shkak të ndjeshmërisë së procesit të rekrutimit, mund të krijohet hapësirë për ndikime të jashtme, trajtim jo të barabartë të kandidatëve ose mungesë	Zbatimi i procedurave të rekrutimit në përputhje me legjislacionin në fuqi për shërbimin civil dhe bashkëpunimi me institucionet kompetente për themelimin e komisioneve	2	3	9	Zbatimi i kriterëve të qarta dhe objektive për rekrutimin; themelimi i komisioneve të paanshme pa konflikt interesi; si dhe sigurimi i transparencës së plotë të procesit përmes monitorimit dhe raportimit	Burimet Njerëzore	2024 – dhjetor 2026

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
		transparence gjatë përzgjedhjes për pozitat e lira.	përkatëse.				institucional.		
5.	Avancimi dhe fuqizimi i legjislacionit të AD-së në përputhje me standardet e BE-së	Mungesa e rishikimit dhe harmonizimit të legjislacionit dhe akteve të brendshme normative të Akademisë së Drejtësisë me standardet evropiane dhe rekomandimet	Koordinimi institucional me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucionet relevante për çështje që lidhen me bazën ligjore dhe aktet normative të AD-së.	7	8	16	Rishikimi dhe avancimi i vazhdueshëm i legjislacionit dhe akteve të brendshme normative në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, KGJK-në, KPK-në dhe akterë të tjerë relevantë, si dhe harmonizimi i tyre me	Departamenti për Shërbime Ligjore dhe të Përgjithshme	Janar - Dhjetor 2026

FUSHAT E PËRGJITHSHME/SPECIFIKE TË RREZIKUT									
Identifikimi i rrezikut			Intensiteti i rrezikut				Masat ndaj rrezikut		
Nr	Fusha e rrezikut	Përshkrimi i rrezikut	Masat ekzistuese të kontrollit	Gjasat	Ndikimi	Vlerësimi	Masat e propozuara për zvogëlimin, eliminimin e rreziqeve	Njësia/Zyrtari	Afati i realizimit
		relevante mund të krijojë paqartësi në zbatim dhe hapësirë për interpretime subjektive.					standartet e Bashkimit Evropian dhe rekomandimet e Komisionit të Venecias.		